

STRATEGJIA ATEISTE DHE IDEOLOGJIA ANTIFETARE E PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE (1943-1990)

NESTI NAÇI

Università degli Studi di Udine, Udine 33100, ITALY
anestinaci@hotmail.com

AKTET V, 4: 614-618, 2012

1 HYRJE

Duke konsideruar kompleksitetin dhe ndërthurjen polisemantike të kësaj teme, mendoj se ajo mund të trajtohet e bazuar mbi tre plane të ndryshme duke i dhënë përparësi herë njërit e herë tjetrit në varësi të elementit të trajtuar. Pra: një interpretim kronologjik; një interpretim analitik dhe një interpretim filozofiko-ideologjik. Ndërsa në këtë tribunë në pamundësi për të sjellë gjithçka pa reduktuar e piatezuar aspektin analitik e pse jo dhe atë shkencor, në varësi të elementit hapësirë, kam zgjedhur një sintezë të planeve nën një stil letrar-diskursiv e ndoshta provokativ duke ekspozuar vetëm disa aspekte e kryesisht të anës më ideologjike.

Në studim analizoj temën e luftës kundër fesë dhe natyrisht teoritë ateiste që rreth saj u ndërtuan duke evituar që gjithçka të precipitonte në konkluzione klishe të një revizionizmi historik, kaq në modë së fundi, për të cilin ajo që vetëm barbarizëm, dhunë e vdekje, dhe që sheh zhdukjen e Zotit si të keqen më ekstreme bërë shqiptarëve gjatë regjimit. Marramendja apo tutkunepsja mbas këtij revizionizmi inercial ka bërë që ateizmi shqiptar të shihet si një regres kulturor dhe analizat të përqendrohen mbi gjykime etike-moraliste duke e konsideruar thjesht një imponim nëpërmjet instrumentesh dhune dhe represioni. Dhe dhuna dhe represioni ekzistuan, dhe ekstreme bile, por nuk ndalet aty ndërtimi i shoqërisë ateiste, e ndoshta nuk ishte as ana më dominante e luftës kundër fesë.

Pikërisht duke konsideruar objektivin që Hoxha kishte vënë, atë të çrënjësjes së mendimit fetar, arma e dhunës nuk paraqet dhe nuk mund të paraqiste një zgjidhje të përshtatshme dhe fitimtare. Përkundrazi, i parë me distancë ky fenomen nxjerr në pah se nuk mund të bëhet fjalë vetëm për një betejë të ashpër e violente kundër botës klerikale, jo një luftë instinktive dhe e diktuar prej bindjeve radikale dhe urrejtjes, por një përballje me fenë dhe botën e saj i bërë programatisht dhe në mënyrë racionale sipas një strategjie origjinale dhe një strukture të qartë mbi të cilën u ndërtua dhe u aplikua një ateologji thellësisht shqiptare.

2. STRATEGJIA

Hapi i parë i ndërmarrë prej drejtuesve të P.K. është i njohur prej kohësh në ideologjinë komuniste, dhe pra është sipas Leninit, lufta e rreptë mbuluar prej një *moderacioni aparent* për ta interpretuar politikisht elementin fetar, klerik apo teologjik qoftë. Fetë, siç thoshte Enver Hoxha, duheshin luftuar “në terrenin tonë” pra, në terrenin e politikës (Morozzo Della Rocca, 2002: 220). Lufta politike e elementit fetar bëhej bazuar mbi akuzat politike që situata e luftës dhe e mbasluftës u ofronte në tavën e argjendte komunistëve. Bashkëpunimi i elementit fetar me pushtuesin fashist ishte një ndër akuzat kryesore, më frekuentja dhe paradoksalisht edhe më e vërteta. Ajo përmbushte objektivin e dyfishtë: të diskreditonte në popull qëndrimin antishqiptar të

njerëzve të zotit, por dhe të “hiqte qafe” krerët më të rrezikshëm e intelektualisht të përgatitur të secilës fe për të vënë në krye të tyre njerëz të besuar të regjimit ose së paku jo kundërshtarë, për të pasur dorë të lirë në hapat e tjerë të strategjisë ateiste. Është kjo periudhë pra, mbaslufta, ku dhuna e kamufluar prej interpretimeve politike shërbeu si armë dominante kundër elementit fetar.

Më pas, lufta politike e fillimit u shoqërua dhe u ndoq nga masa administrative dhe legjislative që të ndërmarra në kuadrin e rinovimit të shoqërisë shqiptare dhe nën dritën e ideologjise marksiste nuk mund të mos godisnin edhe elementin fetar, konsideruar si konservator, obskurantist dhe përgjegjës për prapambetjen e vendit. U fillua nga arsimit, që në të gjitha nivelet u shtetëzua dhe u ndërtua mbi baza ateiste-shkencore dhe në kohë do të gatujë breza të tërë të rinjsh me një kulturë jo vetëm afetare, por thellësisht antifetare dhe ateiste. Edukimi ateist e materialist në shkollë do të kushtëzojë thellësisht jo vetëm jetën por dhe *modus pensandi*-n shoqërisë, ku në kohë do të triumfojë veçse arsyetimi tipik i shkencave ekzakte nën diktatin e logjikës bardhë e zi, duke çrrënjësuar pluralizmin e mendimit humanist. Po kështu nëpërmjet reformës agrare u shpronësuan bashkësitë dhe institucionet fetare duke i detyruar të vareshin plotësisht nga shteti derisa për mosfrekuentim apo deficien të fondesh të mbyllen që mbas luftës një numër i konsiderueshëm qendrash kulti dhe të shkurtohej personeli fetar. Këto masa, përvç anës më evidente të eliminimit fizik të shumë vend-kulteve, do të influencojnë psikologjikisht dhe kulturalisht në konsiderimin e përgjithshëm të fesë dhe gjithë strukturave ku mbeshetjet si “të teperta” dhe natyrisht të njehsoheshin me “gjakpirësit” e tjerë të popullit shqiptar.

Më konkretisht, mbi fenë u ndërhy në vitin 1949 me dekret-ligjin nr. 743 “Mbi komunitetet fetare”, nënshkrimi i të cilit dhe konceptimi në bazë të tij i statuteve të komuniteteve fetare, që do të garantonte ekzistencën juridike të tyre, vulosi dhe nënshtrimin definitiv ndaj regjimit (Jacques, 1995: 502). E fundit u dorëzua Kisha Katolike me Statutin e saj aprovuar prej Kuvendit

Popullor me 30 korrik 1951 (Dervishi, 2006: 634-636; Brunello, 1953: 280-281).

Tapa e fundit strategjike ishte ajo e “lëvizjes nga poshtë”, masive dhe “spontane”, që do të shërbente për të legjitimuar më pas ateizmin shtetëror kushtetues të 1976-ës. Fjalimi programatik i Hoxhës i 6 shkurtit 1967 do të ishte shkëndi nismë dhe udhëheqës “shpirtëror” i masave popullore të përkrahura nga strukturat partiake dhe shtetërore. Lëvizja e kundërfetare e 1967 shërben pra, si vijëndarëse kronologjike e analizës së ateizmit shqiptar, por nuk mund të paraqesë një pikëmbërritje dhe akoma me pak një pikënisje të luftës antifetare dhe ateologjisë së regjimit.

3. IDEOLOGJIA ANTIFETARE (ATEOLOGJIA)

Në kohë lufta kundër fesë u bë ekstreme në planin ideologjik, me objektiv final krijimin e një shoqërie të pafe. Hoxha në Kongresin IV të Partisë në vitin 1961, pra plot 6 vite përpara atij 1967 që shenjon shkatërrimin faktik të elementit fetar në Shqipëri, preokupohet dhe nënvizon: “Çrrënjësja e paragjytimeve fetare, e besimeve të kota dhe e zakoneve të dëmshme është një punë e vështirë dhe delikate. Ato nuk zhduken menjëherë, as me dekrete e as me mitingje. Kjo është një punë që kërkon durim, zgjuarsi dhe takt”. [Hoxha E. (1978), f. 738] Dhe kjo punë tashmë me institucionet dhe personelin fetar të atrofizuar pothuajse plotësisht i takonte sektorëve të kulturës, propagandës dhe edukimit. Por mekanizmi i propagandës nuk mund të ishte efikas, nëse nuk pranohet fakti që ai duhej të mbështetej në një pjesëmarrje aktive; të operonte mbi besimin pothuajse të verbër të popullsisë ndaj Partisë dhe Hoxhës; dhe mbi të gjitha, ateologjia shqiptare do të arrinte në destinacion vetëm mbasi popullsia do të nxirrej prej errësirës shekullore që të ishte e aftë për të përlytur mesazhin divulgativ.

Komunikimi ishte i bazuar në një fjalor të ri, me një gjuhë të përdorur jo më për të ndarë dhe emargjinuar, por për të bashkuar e bërë të ndier për të parën herë një popull të tërë aktiv për fatet e tij dhe pjesëmarrës i vërtetë i jetës së vendit. U prezantohej shqiptarëve një realitet i

dyzuar: nga njëra anë vuajtjet e së shkuarës, errësira shekullore dhe prapambetja, ku fetë të përlyera gjenden gjithnjë në bankën e të akuzuarve si përgjgjëse, dhe nga ana tjetër çka Partia premtonte dhe filloi të impenjohej të ndërtonte nën shenjën e ideologjisë së saj: barazisë e drejtësisë, për tokën atij që e punon dhe për arsimin për të gjithë. Hoxha e dinte fare mirë që përpara se të orientonte dhe influenconte me teori antifetare e ateiste një popull – që dhe pse jo fort besimtar, por gjithsesi injorant – ai duhej zgjuar nga gjumi shekullor. Dhe zgjimi duhej të bëhej gradualisht duke e bërë të kuptonte se fetë ishin ndër përgjgjëset kryesore të kësaj letargjie kulturore, ekonomike, politike, madje dhe ndjenjash kombëtare.

Në Shqipëri fetë u sulmuan nga një pikëpamje gjithsesi perëndimore. Për Hoxhën ateizmi ishte një urë drejt modernizimit dhe arriti t'i bindte shqiptarët se nuk kishte asnjë mundësi progresi të bashkëngjitur me besimin dhe fenë. Ateizmi dhe modernizmi u bënë për shqiptarët elemente të pandara. Moderniteti për Hoxhën ishte *europëizim*, sado që lidhjet politike të tij flisnin gjuhën e Lindjes. Në fakt, po të mendohet, ateizmi shqiptar është shumë më afër kishave të boshatisura të Perëndimit sesa *religjiozitetit* ekstrem të Lindjes ortodokse apo islamike qoftë. Duke konsideruar si faktorin kronologjik ashtu dhe origjinalitetin indoktrinues ndërmarrë prej ateologëve shqiptarë në luftën kundër fesë, ajo mund dhe duhet të shihet e ndarë prej influencës së Revolucionit Kulturor Kinez, siç shpesh cektësisht është afirmuar. Fanatizmi antifetar dhe ateizmi ekstrem të mishëruara në vetë figurën politike, dhe pse jo, intelektuale të Hoxhës, kanë qenë gjithnjë evidente gjatë gjithë periudhës duke filluar qysh në Luftën Antifashiste.

Hoxha kuptoi se popullit të tij, prej shekujsh shtypur prej sulltanësh apo perandorësh me profetë apo fëmijë Zoti nga pas, i ishte nevojitur të mbështillej gjithnjë e më shumë mbas vlerash kombëtare ekstra-fetare për të mbijetuar identiteti i tij. Ai u "dhuroi" shqiptarëve lirinë aq të shenjtë për ta, gjithnjë të nëpërkëmbur nga të huajt turq, grekë serbë apo italianë, së bashku me zotërit apo fetë e tyre, duke u bërë mbrojtës

fanatik i fesë së vetme së shqiptarëve, *Shqiptarisë*. Ai mundi të akuzonte fetë si antishqiptare dhe ksenofile duke ndërtuar nacional-komunizmin e tij kundër fesë dhe mbi një tjetër fe, atë pra të Shqiptarit, atë të Vaso Pashës. Asnjë prej partive komuniste të Lindjes, edhe duke pranuar nëse do të kishin të njëjtën urrejtje antifetare si Hoxha, nuk mund të përdorte armën e nazionalizmit për të luftuar fetë, sepse të gjitha kishin të bënë me kisha ultranacionaliste, që do të ishte e vështirë të akuzoheshin për tradhti të vlerave kombëtare përballë popujve të tyre. Por në Shqipëri kjo mund të bëhej dhe Hoxha nuk vonoi ta kuptonte. Dhe për ta arritur këtë iu prezantuan popullit shqiptar si ateistë dhe antifetarë krerët kryesorë të kulturës dhe të patriotizmit shqiptar.

Ndarja e shqiptarëve në fe të ndryshme, pavarësisht se Hoxha e përdorte këtë faktor për të akuzuar për përçarje fetë që operonin në favor të të huajve, mund të konsiderohet një element më tepër në favor të tij. Nuk mund të them nëse përçarja fetare e popullit shqiptar është shkak apo efekt i tolerancës apo mosfanatizmit fetar që na karakterizon. Por Hoxha dhe ateologët e regjimit të tij, si Hulusi Hako etj., e njihnin mirë këtë karakteristikë të shqiptarëve, që do ta quaja "materializëm", duke e lakuar me një tjetër materializëm, atë marksist. Kalimi i shqiptarëve në masë në islamizëm ishte për këta ateologë një shenjë evidente e materializmit dhe e raportit oportunist apo utilitarist të shqiptarit me fenë. Ky element ka për të qenë fundamental për të luftuar ndjenjën fetare të komuniteti mysliman kundër të cilit u luftua më tepër me dinakëri se me dhunë. Kjo "butësi" pra nuk vjen nga origjina myslimane e diktatorit, siç cektësisht mund të gjykohet, se u soll më mirë me të ngjashmit e tij, sepse Hoxha ishte esencialisht një ateist i bindur, një nacionalist dhe mbi të gjitha një filo-perëndimor. Në fakt, *filo-perëndimizmi* i Hoxhës mund të shihet fare qartë te përpjekjet dhe arritjet në çështjen e gruas, ku emancipimi social i saj dhe shpartallimi deri diku i strukturave mesjetaro-fetare mund të konsiderohet një nga sukseset e vetme të padiskutueshme të politikës hoxhiane. Hoxha ishte i bindur që femrat ishin më

të ndjeshme ndaj çështjes së fesë, sepse mbi to më tepër peshonte obskurantizmi dhe patriarkalizmi fetar. Emancipimi i gruas u arrit duke ndërgjegjësuar masat femërore se kush kishin qenë përgjegjësit e prapambetjes së saj shekullore në shoqëri. Në Shqipëri u arrit në rezultatin e paimagjinueshëm që të luftohej feja me pjesën më konservatore të shoqërisë, duke pasur parasysh rolin fundamental që nëna ka në edukimin e brezave të rinj.

Pra, siç vihet re, teoritë antifetare që prodhoi sistemi ishin më së shumti të llojit të akt-akuzave. Akuzohej feja apo fetë për prapambetjen shekullore dhe obskurantizëm, për përçarje dhe antishqiptarizëm, për shtypjen e popullsisë si një klasë shfrytëzuese, për nënshtrimin dhe poshtërimin e gruas etj., por një teori ishte më origjinalja prej të gjithave: ajo bazohej mbi një *persuasion* të përgjithshëm – pra jo mbi akuza – për të lindur te shqiptarët një ndjenjë narcizizmi apo vetëjoshjeje dhe miti masiv se ata nuk kanë qenë asnjëherë besimtarë e fetarë në historinë tyre. Kjo teori është e kuptueshme që divulgohet më tepër në periudhën *ateokratike*, ku fetë tashmë ishin veçse një kujtim dhe në njëfarë mënyre duhej mbushur e zëvendësuar ai boshllëk i krijuar në nënndërgjegjen e njerëzve. Mite të së kaluarës, me ndihmën e epikës apo krijimtarisë letrare kombëtare, tradita popullore pagane dhe ekstra-fetare, por dhe mite të jetës së re komuniste do të shfaqen dhe do të turbullojnë e influencojnë jo pak mendjet dhe shpirtat e brezave të tërë shqiptarësh. Sot këto mite dhe bestytni laike e kombëtare kanë emra dhe prezantohen në forma të tjera por, jo vetëm shtytjen kryesore, por edhe zanafillën e kanë tek edukimi ateisto-marksist gjatë komunizmit. Mes tyre një që dua vetëm të citoj sa për të dhënë idenë është bindja dhe miti i sotëm mes shqiptarësh që “janë të prirur për shkencat ekzakte” duke mbyllur gjithmonë sytë mbi arsyen e kësaj “cilësie”.

Hoxha u lehtësua në punën e tij nga shumë faktorë, por një që po theksoj është se ai u gjend përballë një besimi fetar të llojit mesjetar. Fetë në Shqipëri nuk i ishin afruar asnjë faze racionalizmi apo shekullarizmi – me përjashtime

elitare – por kishin ngelur në nivele injorance dhe bestytnie, më shumë oportuniste se shpirtërore. As nuk ekzistonte në Shqipëri një klasë borgjeze apo fisnike që të kishte ndërtuar një mendim fetar kombëtar. Kështu që vizioni marksist i jetës u imponua jo mbi një shoqëri borgjeze kristiane, jo mbi një filozofi fetare, por mbi një fe obskurantiste, mesjetaro-bizantine e mbajtur në këmbë prej një kleri injorant dhe oportunist.

4. KONKLUZIONE

Sot duke analizuar atë periudhë dhe duke konsideruar konceptet dhe mentalitetin që shqiptarët kanë mbi Zotin dhe fenë – dhe pa ndihmën e sondazheve që nxjerrin Shqipërinë si një vend ku 60% e popullsisë deklarohet ateiste apo anjostike [US Department of State - *International Religious Freedom Report* (2006)] – mund të thuhet se ateizmi shtetëror ka kushtëzuar jo pak mentalitetin, kulturën dhe konceptet e popullit tonë. Ndoshta Hoxha dhe komunizmi i tij kombëtar nuk arritën në idealin e ateizmit që të çrrënjosnin nga mendja e njerëzve idenë e Zotit, por arritën sigurisht në një tjetër rezultat akoma më të rëndësishëm, atë të zhvlerësimit total të feve duke i zhveshur prej çdo ekskluziviteti pushteti për të garantuar ngritjen shpirtërore dhe shpëtimin e njeriut edhe mes besimtarëve të mbetur. Shqiptarët njohin fenë sipas një mënyre krejt të tyre duke i konsideruar çështje tokësore dhe institucione historike në luftë prej shekujsh për pushtet. Ata, për mendimin tim, duhet të jenë krenarë për ateizmin apo anjosticizmin e tyre, pa u munduar ta minimizojnë apo ta fshehin mbas asaj aq të hyjnuar “tolerancë fetare”. Duhet të dinë se Evropa nuk është Perëndim (në kuptimin e mirë të fjalës) vetëm sepse kristiane apo katolike, por pikërisht dhe falë atyre martirëve mendimtarë që kanë shkuar kundër krishtërit, kundër obskurantizmit që dhe kjo fe ka mbajtur njerëzimin. Ata duhet të kuptojnë se nuk mund të fshijnë paragjykimin krijuar mbi ta nga Evropa se “janë kryesisht myslimanë” (si të ishte diçka negative), duke kërkuar t’i rilidhen artificialisht të shkuarës së tyre të largët kristiane, por pikërisht duke rivendikuar me forcën e arsyes të tashmen

e tyre ateiste apo agnostike dhe pse pjesërisht të trashëguar prej diktaturës komuniste.

BIBLIOGRAFIA

AKADEMIA e Shkencave të Shqipërisë (2002), *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I – II – III – IV, Toena, Tiranë.

BEQAJ, R. (1972), *Veprimtaria armiqësore e klerit katolik shqiptar 1945-1971*, Shtëpia botuese e librit politik, Tiranë.

BRUNELLO, A. (1953), *La chiesa del silenzio*, Paoline edizioni, Roma.

CAVALLI, F. (1947), Persecuzione religiosa nell'Albania comunista: *La Civiltà Cattolica*, I, 2327, 24 aprille-7 maggio, II, 2330, 12 giugno-25 giugno Roma.

DERVISHI, K. (2006), *Historia e Shtetit shqiptar*, 55, Tiranë.

GENTILE, E. (2007), *Le religioni della politica, fra democrazie e totalitarismi*, Laterza, Bari.

HAKO, H. (1967), *P.P.SH mbi fenë dhe edukimin ateist-shkencor të punonjësve*, 8 Nëntori, Tiranë.

HAKO, H. (1972), *Gjyq Zotit*, Shtëpia botuese e librit politik, Tiranë.

HAKO, H. (1983), *Ateizmi shkencor*, 8 Nëntori, Tiranë.

HOXHA, E. (1978), *Çështje të revolucionit dhe të ndërtimit socialist*, Vëll. I (1942-1961) – Vëll. II (1961-1970), 8 Nëntori, Tiranë.

HOXHA, E. (1985), *Për shkencën*, Vëll. I (1942-1975) – Vëll. II (1976-1984), 8 Nëntori, Tiranë.

JACQUES, E. (1995), *Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Kartë e pendë, Tiranë.

MENEGATTI, L. (1972), *La lunga marcia del popolo albanese dal feudalesimo al socialismo*, Cultura editrice, Firenze.

MOROZZO DELLA ROCCA, R. (2002), *Nazione e religione in Albania*, Besa, Lecce.

PËRMBLEDHJE e përgjithshme e legjislacionit në fuqi të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, vëll. I, 1945-1979 (1979), (s.e) Tiranë.

PLLUMI, Zef. (2006), *Erro vetëm për me tregue*, 55, Tiranë.

ROMANO, A. (2002), *Lo stalinismo*, Mondadori, Milano.

SAKO, Z. (1967), *Populli dhe Feja*, Naim Frashëri, Tiranë.

SHESTANI, Z. (1959), *La chiesa in Albania*, (s.e), Cremona.

US DEPARTMENT OF STATE - International Religious Freedom Report (2006):

<http://www.state.gov/g/drl/rls/irf/2006/71364.htm> Released on September 15, 2006.